

V E N D I M
“PËR VËNIE SEKUESTRO PREVENTIVE”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga :

GJYQTARE : REZARTA BALLIU (VIGANI)

asistuar prej sekretares gjyqesore Loreta Merepeza, sot datë 17.04.2015 mori në shqyrtim , kërkesën penale në ngarkim,

KERKUES : Prokuroria, pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga prokurori Ndini Tavani .

OBJEKTI : Vendosja e sekuestros preventive .

BAZA LIGJORE: Neni 274/2 i K.Pr.Penale.

1. *Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën e prokurorit i cili kërkoi – vendosjen e sekuestros preventive dhe pasi e bisedoi dhe shqyrtoi çështjen në tërësinë e saj,*

V Ë R E N

Se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e materialeve të ardhura nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, ka regjistruar procedimin penal me Nr..... të vitit 2015, për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose I veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal .

Nga hetimet paraprake ka rezultuar se, Shtetasi D K, ka krijuar shoqërinë “F.....” sh.p.k në Shqipëri nëpërmjet kësaj shoqërie ky shtetas dhe familjarët e tij kanë kryer transaksione në vlera të larta ku rezultojnë transferta hyrëse në vlera të konsiderueshme nga shoqëritë në Itali “D.....” Srl dhe “A.....” Itali (në një vlerë totale për 2013-2015 afërsisht 15 mln EUR) .

Këto fonde të përfituara janë transferuar kryesisht drejt Zvicrës me përshkrime “Trafik telefonik” sipas kontratës por edhe për shërbime konsulence në shoqëri me seli në vende të ndryshme si Kinë. Angli etj.

Për vërtetimin e burimit të fondeve dhe përdorimin e tyre në bankë ka deklaruar se: Pajisjet për shërbimet që kryen i ka të vendosura ne

Zvicër. Ne ambientin që ka biznesin në Shqipëri nuk ka asnjë pajisje të cilat mund të shërbenin për të kryer trafikun e shërbimit telefonik.

Nuk zotëron ndonjë licencë profesionale për ushtrimin e aktivitetit në Shqipëri dhe se aktiviteti i tij nuk ka nevojë për licencim nga asnjë autoritet shqiptar të tilla si AKEP apo ndonjë tjetër.

Në datë 26.02.2013 (10 ditë pas krijimit) shoqëria "F....." (pala blerëse) e përfaqësuar nga D K ka lidhur kontratë me shoqërinë "S....." (pala shitëse) e përfaqësuar nga V. J. dhe A. F.. Objekt i kësaj kontratë është të shesë/blejë të njëra tjetra trafik telefonik kombëtar dhe ndërkombëtar. (kjo kontratë është depozituar në të dy bankat Union dhe Procredit . Për F.....është cilësuar se kalimet do të bëhen në nr e llogarisë pranë ISP).

Në datë 16.12.2014, shtetasi F. K. së bashku me shtetasen A. N. K. si palë blerëse kanë lidhur kontratë blerje për rezervim apartamenti në vlerën **90.000 EUR**. Pala sipërmarrëse është shoqëria "S...." sh.p.k me NIPT J....., e përfaqësuar nga shtetasi N. M... Të ardhurat janë deklaruar nga puna në emigracion. Për mënyrën e pagesës është cilësuar:

- A) Kësti i pare 16.000 EUR, likuiduar me nënshkrimin e kontratës, nëpërmjet
- B) Kësti i dyte 9.500 EUR, do likuidohet deri me 30.01.2015 nëpërmjet BKT.
- C) Kësti i trete 64.500 EUR, do te paguhet deri 28.02.2015 nëpërmjet një kredie nga BKT.

Po në datë 16.12.2014, shtetasi F... K... si palë blerëse ka lidhur kontratë blerje garazh në vlerën **10.000 EUR**. Pala sipërmarrëse është shoqëria "S...." sh.p.k me NIPT J..., e përfaqësuar nga shtetasi N. M.. Të ardhurat janë nga puna në emigracion. Për mënyrën e pagesës është cilësuar se:

- D) Kësti i pare 3.000 EUR, likuiduar me nënshkrimin e kontratës nëpërmjet BKT.
- E) Kësti i dyte 7.500 EUR, do te paguhet deri 28.02.2015 nëpërmjet një kredie nga BKT.

Në datë 19.01.2015, shtetasi D. K. së bashku me shtetasen E. P. T., si palë blerëse kanë lidhur kontratë për prenotim apartamenti në vlerën **104.000 EUR**. Pala sipërmarrëse është shoqëria "K..." sh.p.k me NIPT K....., e përfaqësuar nga shtetasi S. K..

Nga verifikimi në Q.K.R në emër të tyre rezultoi se, në datë 14.09.2011, D. K. ka krijuar biznesin "**D...**" **PF** me NIPT L..... Objekti i veprimtarisë "Grumbullim të frutave pyjore,boçeve të pyjeve dhe rreshires se pishave.Mbarshtimin e faunes se eger pyjore dhe ushtrimin e gjuetise turistike, eksport - import të produkteve të faunes se eger,eksport - import të produkteve të dyta pyjore, boçeve të pishes dhe llojit xine.Krijimin e

rezervateve per shpende e kafshe e egra dhe administrimin e tyre. Import eksport te produkteve bujqesore, inpute bujqesore dhe amballazhim.Import-eksport te materialeve te ndertimit,import-eksport te lendeve drusore etj”. Adresa “..... Lagjja "...Rruga"", Godine 3 katëshe, kati i 1, pranë kompleksit M..... ”.

Në datë 13.04.2012 D K dhe F K, kane krijuar shoqërinë **“F.....” shpk**, me NIPT L..... Objekti i veprimtarisë “ Ndertime civile dhe industriale, rikonstruksion godinash, veshje fasadash etj. Punime dheu, sistemime, tarracime terrenesh, vepra kullimi dhe vaditese. Ndertim rruge kat. 4 dhe 5, veshje rugesh me asfaltbeton, ndertim mbishtrese etj” dhe në datë 13.05.2012 (pas një muaj që ishte krijuar) shoqëria kalon në proces Likidimi.

Në datë 15.02.2013, krijuan biznesin **“F.....”** me NIPT L..... Objekti i veprimtarisë “Shitje blerje, tregtim te trafikut telefonik me shumice”. Adresa “. Lagja 29, rruga K....., pallati 8, kati 3”. kapitali 100.000 Lek.

Në datë 17.10.2014 D K dhuron 50 % të kuotave te i vëllai shtetasi F K duke u bërë secili ortak me nga 50 % të kapitalit.

Në datë 03.04.2014 D K (me 20 %) dhe F K (20 %) kanë krijuar shoqërinë **“P.....”** me NIPT L..... në bashkë ortakëri me shtetasit M. L. L. 20 %, C. G. T. 20 %, I. M. P.. Adresa, Shtëpi private në Rrugën “N.....Nr.97 . Kapitali 1.000 Lek.

Nga verifikimi në lidhje me bizneset në emër të biznesit **“D.....” PF**, rezultojnë:

Zhdoganime në periudhën tetor-nëntor 2011 të mallrave - boçe pishe.

Në datë 23.08.2012, D. K. tërheq 15.500 USD.

Në datë 07.09.2012, tërheq 1.513.000 Lek.

Në datë 26.09.2012, tërheq 10.450 USD.

Në datë 14.11.2012, tërheq 14.790 EUR.

Në datë 07.02.2013, tërheq 9.930 EUR.

Në datë 09.12.2014, tërheq 10.000 EUR.

Në datë 14.01.2015, tërheq në total 7.080 EUR dhe 62.000 Lek.

Në emër të bizneseve **“F.....” shpk dhe “P.....”** nuk rezultojnë transaksione.

Në emër të biznesit **“F.....” sh.p.k** rezultojnë transaksione të kryera në bankën “Union” dhe “Procredit”, transferta hyrëse dhe dalëse me përshkrime për likuidim faturash trafik telefonik tërheqje si dhe transferime ndërmjet llogarive në EUR dhe USD për këmbime valutore .

Në datë 28.02.2013, ai ka krijuar shoqërinë “D.....” srl në Itali (kapitali 10.000 euro, me ortak 99% D. K. dhe 1 % A. K.. Administrator M. P.. Objekti i veprimtarisë të ofroje shërbime ne sektorin e telekomunikacionit, telefonisë kombëtare e ndërkombëtare. shërbime në aksesim interneti etj.

Në datë 26.03.2013, shoqëria “F.....” sh.p.k (pala shitëse) e cilësuar në kontratë se përfaqësohet nga shtetasi A. K. (drejtor), ka lidhur kontratë më shoqërinë “D.....” (pala blerëse) e përfaqësuar nga D. K..

Në fund kontratat janë nënshkruar për të dyja palët “F.....sh.p.k dhe “D.....” srl nga D. K. (edhe pse ne kontratën e dt 26.03.2013 është cilësuar se shoqëria “D.....” srl përfaqësohet nga A. K.).

Në datë 01.08.2013, shoqëria “F.....” e përfaqësuar nga D. K. ka lidhur kontratë më **W.....**- Zviceër për shitblerje trafik telefonik ndërkombëtar e përfaqësuar nga administratori i saj R. M..

Në datë 01.09.2013, shoqëria “F.....” e përfaqësuar nga D. K. ka lidhur kontratë më shoqërinë “I.....” ...e përfaqësuar po nga administratori i saj P. R.. (kjo kontratë është depozituar në të dy bankat Union dhe Procredit. _Objekti i kontratës për ofrim nga ... shërbim telefonik ndërkombëtar. Ndërkohë që kontrata e bankës Union është e nënshkruar vetëm nga njëra palë e kontratës, D. K. ndërsa kontrata e depozituar ne bankën Procredit është e nënshkruar nga të dy palët).

Në datë 02.09.2013, shoqëria “F.....” e përfaqësuar nga D. K. ka lidhur kontratë për marrje konsulence nga shoqëria “T.....” (T....) e përfaqësuar nga administratori i saj R. M., (i cili është edhe administrator i shoqërisë W.....me të cilën shoqëria F.....ka lidhur kontratë për shitje shërbime telefonike)

Në datë 12.11.2013, shoqëria “F.....” e përfaqësuar nga D. K. ka lidhur kontratë për marrje konsulence nga shoqëria “Z.....di P. Z.” , me adresë M....-Itali.

Në datë 24.01.2014, shoqëria “F.....” e përfaqësuar nga D. K. ka lidhur kontratë me shoqërinë “A.....” e përfaqësuar nga administratori i saj A. T. Objekti i kontratës është palë të blejë dhe/ose te shesin nga njëra tjetra shërbime telekomunikacioni (me shumicë). Pala shitëse do ti siguroje palës blerëse trafikun telefonik ndërkombëtar (e njëjta kontratë është depozituar në të dy bankat Union dhe Procredit).

Ndërkohë që vihet re se shoqëria “A....”, ka te njëjtën adresë me “D.....” e cila ka ortak vëllezërit K.....

Në Bankën Procredit, është depozituar kontrata e lidhur ndërmjet shoqërisë “F.....” dhe “Z.....”. Ndërsa në fund kontrata rezulton e sigluar për llogari të shoqërisë “I.....” S.a dhe jo të “Z.....”.

Nga verifikimi në lidhje me familjarët:

F) Në emër të shtetasit **A. K.**, i datëlindjes 14.12.1943 dhe **B. K.**, e datëlindjes 21.10.1953, nuk rezultojnë transaksione të kryera.

G) Në emër të shtetasës **E. Th./K.**, nuk rezultojnë transaksione të kryera.

H) Në emër të shtetasës **A. K.** rezultojnë:

I) Në datë 12.12.2014, ka depozituar 19.050 EUR.

J) Në datë 29.01.2015, ka depozituar 9.500 EUR, në llogarinë e përbashkët që ka me shtetasin F. K..

Nisur nga transaksionet e larta si dhe anomalitë e kryera nga shtetasit e lartpërmendur nëpërmjet krijimit të disa aktiviteteve, nuk janë produktive në vendin tonë.

Subjekti F.....është nje subjekt i rregjistruar prane organeve tatimore te Republikës së Shqipërisë dhe si i tille është i detyruar sipas legjislacionit tatimor te paguaje tatimet lidhur me te ardhurat , fitimin dhe TVSH-sh sipas bilancit te faturave te realizuara ne shitje dhe ne blerje . Ne çeshtjen objekt hetimi dyshohet se nga ana e subjektit nuk është bere asnje pagese lidhur me tatimet e taksat.

Nga të dhënat e siguruar , Gjykata çmon se ka dyshime të bazuara në prova se, në rastin konkret pasuritë e shumta, janë produkte të veprave penale ose i veprimtarisë kriminale, i shtetasve D. K., F. K. dhe subjektit “F.....”, janë krijuar mbi bazën e të ardhurave të siguruar nga aktiviteti kriminal , të cilat nuk justifikohen nga pikëpamja ekonomike sepse nuk identifikohen burime të ligjshme të ardhurash për të siguruar këto pasuri, sigurimi ose krijimi i këtyre pasurive pas periudhës së dyshuar kriminale.

Organi i akuzës në mbështetje të nenin 274/2 të Kodit të Proçedures Penale dhe nenit 36 të Kodit Penal , vlerëson të nevojshme vendosjen e sekuestros preventive mbi llogaritë e përshkruara me lart duke qenë se disponimi i lire i tyre mund të rëndojë dhe zgjase pasojat e veprës penale për të cilën është regjistruar ky proçedim penal, duke sjelle tjetërsimin ose transferimin e tyre tek persona të tretë .

Gjykata , referuar provave shkresore bashkëlidhur kerkesës çmon se kërkesa mbështetet në ligj e prova dhe duhet të pranohet . Ajo mbështetet në Nenin 274 pika 1, 2 të Kodit të Proçedures Penale. Kjo dispozitë parashikon rastet e vendosjes se sekuestros preventive mbi pasurite që mund të lejohen të konfiskohen, sipas përcaktimeve te nenit 36 të Kodit Penal. Kjo dispozite penale, në pikën 1.b.ç të saj, parashikon si sende te

konfiskueshme çdo pasuri tjetër, vlera e se ciles korrespondon me ate te produkteve te vepres penale.

Përsa mësipër , gjykata në përfundim të shqyrtimit të kërkeses çmon se, në rastin konkret pasuritë e shumta dyshohet se, janë produkte të veprave penale ose i veprimtarisë kriminale, si dhe ka rrezik që disponimi i lirë i tyre mund të rendojë pasojat e vepres penale për të cilën është regjistruar ky procedim penal, duke u tjetërsuar ose transferuar dhe arrin në përfundimin se, kërkesa e prokurorit, plotëson kushtet dhe kriteret ligjore të përcaktuara në nenit 274 te Kodit të Proçedurës Penale dhe nenit 36 të Kodit Penal, për vendosjen e sekuestros preventive .

PËR KËTO ARSYE

Gjykata në bazë të nenit 274 të K.Pr.Penale dhe nenit 36 të K.Penal

V E N D O S I

- I. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si të bazuar në ligj dhe në prova .
- II. Vendosjen e sekuestros preventive të llogarive bankare në emër të shtetasve D K., F. K. dhe subjektit “F.....”, pranë Procredit Bank dhe konkretisht të shumës në euro depozituar dhe ndodhur në llogarinë:
 - I. EUR (1...2) shuma **751,345.71 EUR.**
 - II. LEK (1...1) shuma **6,778 LEK**
 - III. USD (1...3) shuma **705.31 USD .**
- I. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 10 ditëve në Gjykatën e Apelit ose rekurs i drejpërdrejtë në Gjykatën e Lartë .
- II. U shpall sot me datë 17.04.2015 Tiranë.

SEKRETARE
Loreta MEREPEZA

GJYQTARE
Rezarta BALLIU

(VIGANI)

